

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 25-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale,**  
**mbajtur më 1.8.2023**

**Anëtarë të pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr. Arben Saiti, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë: /**

Z. Petrushevski hapi seancën e njëzet e katërt të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 12:35 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski njoftoi se titulli i Pikës 4 do të ndryshjë si vijon: Propozim-aktvendim për ndalim të procedurës së inicuar për heqje të lejes për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota „pro“ (votimi i z. Fidanovski ishte nëpërmjet lidhjes audio), miratoi të korrigjuar si në vijim:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e njëzet e katërt e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 21.7.2023.
2. Shqyrtimi i Raporteve tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për periudhën nga 1 prill deri më 30 qershor 2023.
3. Propozim-vendim për heqje të lejes për transmetim televiziv të SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip.
4. Propozim-aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqje të lejes për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar.
5. Të ndryshme.

## **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri (votimi i z. Fidanovski ishte nëpërmjet lidhjes audio), miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e njëzet e katërt e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 21.7.2023, me teks siç u propozua.

## **Pika 2**

Z. Petrushevski njoftoi shqyrtimin e Raporteve tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga 1 prill deri më 30 qershor 2023 dhe sqaroi se Këshilli nuk i voton, por mund të diskutojë dhe të japë mendim. Ai shpjegoi se sipas tij Raporti është punuar mirë dhe standart, gjegjësisht Agjencia vazhdon në kontinuitet të punon në mënyrë kualitative dhe profesionale.

Z. Ajdini tha se edhe më parë, edhe në këtë Raport tremujor janë prezantuar të gjitha aktivitetet e Agjencisë që janë realizuar në tremujorin e kaluar. Por ajo që mendon se duhet theksuar është pjesëmarrja e Shërbimit profesional në numër të madh takimesh, punëtorish, debatesh dhe aktiviteteve ndërkombëtare. Kjo dëshmon se Agjencia në mënyrë profesionale dhe adekuate e kryen punën e saj.

Z. Fidanovski tha se ka një pyetje të shkurtër drejtuar shërbimit lidhur me progresin e zhvillimit të Strategjisë për zhvillimin e veprimtarisë audio dhe audiovizuele për vitin 2024-2028.

Z. Trajçevski shpjegoi se diku nga fundi i muajit qershor të këtij viti është mbajtur takim ku është prezantuar se çfarë është arritur dhe në cilën fazë të zhvillimit është ky dokument strategjik dhe gjatë kësaj periudhë është hartuara Drafti për strategjinë rregullative për 5 vitet e ardhshme. Ai shpjegoi se pas mbarimit të pushimeve verore do të mbahen sërish takime pune me praninë e të gjitha palëve të interesuara, përfshirë këtu edhe Këshillin e Agjencisë, për të krijuar versionin përfundimtar që duhet miratuar deri në fund të dhjetorit të këtij viti.

## **Pika 3**

Udhëheqësja e Sektorit për mbështetjen (përkrahjen) e punës së Drejtorit dhe Këshillit të Agjencisë-Shef kabineti mr. Dragica Ljubevska shpjegoi Propozim-vendimin për heqje të lejes për transmetim televiziv të SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip. Ajo shpjegoi se më 12 korrik 2023, TV Iris drejtuar Agjencisë ka dorëzuar Shkresë në të cilën ndër të tjera ka deklaruar se për shkak të gjendjes së vështirë financiare në të cilën ndodhet nuk është në gjendje të transmeton program televiziv dhe njoftoi se do të kthen lejen për transmetim televiziv. Menjëherë pas kësaj Agjencia i dërgoi Shkresë televizionit, duke informuar median se çfarë është e nevojshme të dorëzon nëse ndërpreme transmetim të programit televiziv. Bazuar në këtë shkresë, dhe duke vepruar sipas detyrës zyrtare Sektori i mbështetjes informative dhe i punëve të përgjithëshme ka kryer kontroll në sistemin e monitorimit të shërbimeve televizive dhe radio që disponon Agjencia dhe gjatë kontrollit është konstatuar se TV Iris nuk ka transmetuar program për më shumë se 90 ditë. Për këtë arsye, drejtori i Agjencisë ka paraqitur propozimin për inicim të procedurës për heqje të lejes për transmetim televiziv ndërsa Këshilli i Agjencisë në seancën e njëzet e katërt e cila u mbajt më 21 korrik e miratoi propozimin. Në lidhje me procedurën e inicuar për heqje të lejes, Agjencia i dërgoi

njoftim TV Iris dhe i tregoi se nëse menjëherë nuk e harmonizon punën e tij dhe nuk fillon me transmetim të programit televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit nga drejtori, do të marrë Vendim për heqje të lejes. Ndërkohë, më saktë më 31 korrik, Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit ka dorëzuar njoftim për punën e TV Iris në të cilën thuhet se Këshilli i Agjencisë në seancën e 15-të mbajtur më 18.5.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimeve nga neni 15 paragrafi (1) dhe (3) të Ligjit për Media, transmetuesit i është shqiptuar masë vërejtje publike dhe është urdhëruar që në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit për marrjen e masave për harmonizimin e punës së tij me dispozitat e Ligjit për Media. Aktvendimet për ndërmarrjen e masave vërejtje publike ishte pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit, por edhe pas skadimit të afatit për harmonizim që ishte deri më 21 korrik TV Iris nuk e ka harmonizuar punën e tij, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për heqjen e lejes në pajtim me LSHMAAV. Sektori i mbështetjes informative dhe i punëve të përgjithëshme më 28 korrik ka kryer mbikëqyrje kontrolli, sipas detyrës zyrtare dhe përgatiti Raport me shkrim nga mbikëqyrja administrative nga ku është konstatuar se TV Iris nuk ka harmonizuar punën e tij gjegjësisht nuk ka filluar me transmetim të programeve televizive. Për këtë arsye drejtuar Këshillit të Agjencisë u dorëzua propozim për miratim të Vendimit për heqje të lejes për transmetim televiziv të TV Iris nga Shtipi.

Z.Trajçevski shtoi se në fund të muajit qershor të këtij viti Agjencia ka lëshuar faturë për kompensim vjetor për lejen e TV Iris e cila duhet të pagohet në afat prej 30 ditësh, por për shkak të gjendjes së vështirë financiare në të cilën ndodhen, nga dërgesa e faturës pasi kanë kaluar 45 ditë Agjencia nuk mund t'ua dorëzojë, në fakt nuk mund ta paguajnë sepse ndërkohë është hapur procedura e falimentimi.

Z. Trajçevski, pas shpjegimit tha se gjithësesi leja do t'i hiqej, aq më tepër që vetë transmetuesi në shkresë ka cekur se dëshiron ta kthejë lejen. Ai tha për Këshillin kjo paraqet një detyrë të pakëndshme, por në pajtim me Ligjin duhet të veprojë në këtë mënyrë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri (votimi i z. Fidanoski ishte nëpërmjet lidhjes video) miratoi Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, nr.08-902 datë 8.7.2015, për shkelje të nenit 82 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta zyrtare e RMV-së“ nr.42/20 dhe 77/21), gjegjësisht poseduesi i lejes ka ndërprerë transmetimin e shërbimit programor për më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare dhe arsye të tjera.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të njoftojë ORRPKE me të cilin transmetuesi ka lidhur marrëveshje se Këshilli i Agjencisë ka miratuar Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR televizion IRIS SHPK Shtip.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikon në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“, në ueb faqen e Agjencisë dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra në gjuhën e bashkësive joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### **Pika 4**

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit-Shef kabineti mr. Dragica Ljubevska shpjegoi Propozim-aktvendimin për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar. Ajo shpjegoi se Këshilli i Agjencisë në seancën e 23-të e cila u mbajt më 19 korrik , ka inicuar procedurë për heqje të lejes për këtë transmetues për shkak se nuk e kishte paguar kompensimin (tarifën) vjetore për leje në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të faturës. Gjatë ditës së djeshme është informuar se RADIO BALLKAN FM e ka kryer pagesën plotësisht dhe për këtë ka njoftim dhe nga Sektori për financa dhe logjistikë. Për këtë arsye, i propozohet Këshillit që të ndalojë procedurën e inicuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri (votimi i z.Fidanoski ishte nëpërmjet lidhjes audio) miratoi Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqje të lejes për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, nr.08-437 datë 15.8.2016.

Në pajtim me faturën e lëshuar, transmetuesi i lartpërmendur ka paguar plotësisht kompensimin vjetor për leje të transmetimit në radio.

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

#### **Pika 5**

#### **Të ndryshme**

Nuk ka diskutim nën Të ndryshme.

**Nr. 02-2966/4**

**15.08.2023**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale,  
Kryetari i Këshillit  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**